

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: BLERJE DYER TAMBURATO TE RIMESUARA + DYER

D/ALUMINI.

(PER NEVOJA TE BASHKISE)

BASHKIA DIBER

Bazuar në buxhetin e vitit 2022 , të Bashkisë Dibër, për blerjen e dyerve tamburato të rimesuara dhe dyer d/alumini, për nevoja të Bashkisë, me fond limit prej 5 000 000 lek të reja me tvsh, dhe 4 166 666 lek pa tvsh, nga ana jonë, nisur nga nevojat e domosdoshme dhe emergjente, u hartua preventivi me sasite, modelin e dyerve tamburato të rimesuara dhe dyerve d/alumini.

Nga ana jonë përpara fillimit të hartimit të preventivit përkates, u bë një kontroll i gjithë objekteve publike të Bashkisë Dibër, duke parë gjendjen e atyre ekzistuese dhe sasitë e domosdoshme që kishin nevoje për zëvendësime.

Dyert tamburato të rimesuara dhe dyert d/alumini do të prodhohen nga sipërmarresi sipas specifikimeve të mëposhteme:

A. Dyer të brendshme tamburato të rimesuara.

Furnizim dhe vendosja në veper e dyerve të brendshme tamburato me një kanat, me ngjyre sipas porosise së investitorit, do të kenë përmasa 90x200 cm.

Lënda e drurit që do të përdoret të jetë e stazhionuar dhe sipas standarteve shteterore.

Bravat të jenë të sigurta me çelës dhe doreza tunxhi, dhe piastra e gojeza perkatese.

Dyert e brendshme tamburato të rimesuara, prej druri pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë, do të përbëhen nga një kasë e bërë me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 4 cm) e trajtuar me një mbulesë mbrojtëse të drunjtë, e dimensionuar sipas permasave të mesiperme 90 x 200 cm.

Dyert do të jenë të përforcuar mirë në pjesët e brendshme të sajë, me struktura druri, të cilat duhet të sigurohen të paktën nga 3 mentesha me gjerësi minimale 16 cm.

Një bravë metalike sekrete dhe tre kopje çelësash, doreza dyersh dhe doreze shtytëse të derës.

B. Dyert e brendshme prej duralumini do të përbëhen nga:

Kasa fikse në formë profilesh tubolare prej duralumini me thellësi 61-90 mm, të cilat sigurohen me elemente të posaçëm për fiksimin dhe mbërthimin në strukturat e mureve. Profilet fikse të kasës do të jenë me një mbulesë jo më e vogël 25 mm larg murit.

Kanata lëvizëse në formë profili duralumini me një thellësi prej 32 mm dhe një lartësi prej 75 mm i rrafshët ose me zgjidhje ornamentale.

Profili duhet të jetë me një hapësirë qendrore që nevojitet për futjen e bashkuesve të qosheve (me hapësirë prej 18 mm) .

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standartet shtetërore.

Theksojme se ngjyra d/aluminit, për prodhimin e dyerve do të jetë sipas porosise së investitorit dhe do të kenë permasa 80 x 190 cm. me profile d/alumini prodhim italian dhe me spresore të forta dhe të qëndrueshme. Këto dyer kryesisht do të përdoren dhe vendosen në ambjentet e njeve sanitare të objekteve publike si shkolla, kopshte , çerdhe e t.j.

Dyert e d/aluminit do të jenë në të gjithë sipërfaqen të mbushura me elemente d/alumini, pa xham.

Nga ana e operatorit fitues, përpara se të fillojë prodhimin e dyerve në fjalë, do të konsultohet me specialistet e Bashkisë, duke parë me parë modelin dhe cilësinë e dyerve të prodhuara për klientet e tjerë, për të fiksuar përfundimisht modelin dhe ngjyrën e tyre.

SHENIM : *Dyert në preventiv janë parashikuar, prodhim dhe vendosje në objekte. Operatori fitues, kontraktuesi i këtij tenderi duhet të kontaktojë me Bashkinë Diber, me specialistet që e kanë kryer këtë preventiv, para prodhimit dhe blerjes së tyre.*

HARTOJ:

Ing. Bedri Shehu

Peshkopi me 17. 10. 2022

